



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

Prill, 2017

### MASHT dhe SBASHK nënshkruan kontratën e re Kolektive **Moment i veçantë për tërë arsimin e Kosovës**



Për të gjitha sindikatat kudo në botë moment i veçantë dhe arritje e madhe konsiderohet nënshkrimi i Kontratës Kolektive. Lidhur me Kontratën e re Kolektive në arsimin e Kosovës kishin biseduar me kohë përfaqësuesit e SBASHK-ut me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij. Komisionet kishin punuar dhe pas takimeve negociuese kishin arritur të përgatitnin tekstin final të Kontratës së re Kolektive për tërë arsimin e Kosovës. Ceremonia festive e nënshkrimit të Kontratës së re u zhvillua në kabinetin e Ministrit Bajrami në prani të Zv/ministrit Mevludin Krasniqi, anëtarëve të Kabinetit dhe përfaqësuesve të SBASHK-ut ... (faqe 5)

Takim me kryeministrin Mustafa dhe kabinetin e tij

**Kryetari i SBASHK-ut i kërkoi Kryeministrin të vazhdojë me mbështetjen për Ligjin e viteve 90-ta**

Një delegacion i BSPK-së, i kryesuar nga kryetari Haxhi Arifi, është pritur nga ....(faqe 7)

Intervistë me aktorin e sindikalistin z.Naser Zymberi

**Naseri i dalluar në skenë dhe në angazhime sindikale**

Naseri rrëfen gjëra interesante në intervistën për gazetën tonë. Kishte krijuar me mjete modeste edhe një radio stacion. Skena për të është jeta vetë... (faqe 3)

Takimi i Këshillit Drejtues

**U debatua edhe për çështje të organizimit të brendshëm**



Edhe pse Statuti i SBASHK-ut parasheh që takimet e Këshillit Drejtues duhet mbajtur më se shumti....(faqe 6)

Takim përmbajtjesor me Ministrin e Kulturës, Kujtim Shala  
**Pajtueshmëri për Kontratën Kolektive në sektorin e kulturës**



Pas nënshkrimit të Kontratës së re Kolektive për gjithë arsimin e Kosovës, SBASHK-u po vazhdon... (faqe 7)



## Editorial

### Kontrata e re Kolektive e arsimit të Kosovës



Edhe nga opiniononi edhe nga mediet është vlerësuar si ngjarje e ditës nënshkrimi i Kontratës së re Kolektive për sektorin e arsimit të Kosovës. Ky moment festiv ka ardhur falë përkushtimit dhe korrektësisë së asistentit të Ministrit Bajrami, Fatonit, të Kabinetit të Ministrit dhe angazhimit të madh të SBASHK-ut.

SBASHK-u ndihet mirë pas nënshkrimit të kësaj Kontrate sepse ajo tanimë, nuk është vetëm e Arsimit Parauniversitar, por është edhe e Universiteteve.

*Të veçantat dhe risitë në Kontratën e re Kolektive për Arsimin e Kosovës janë se Kontrata e re është për tërë sektorin e arsimit në Kosovë, pra jo vetëm për Arsimin Parauniversitar, siç ishte Kontrata e kaluar, por edhe për Universitetet.*

Pastaj, pagat jubilarë sipas Kontratës së re precizohen të jepen për të punësuarit në arsim në vitet jubilarë dhe atë:

10 vite punë – 50 % e pagës bazë  
,20 vite – 75 % e pagës bazë,30 vite- vlera e një page bazë,40 vite - `150 % , apo një pagë e gjysmë. Kontrata e re thotë se ky shpërblim, pra në emër të pagës jubilarë të bëhet çdo 7 Mars, pra për ditën e mësuesit dhe shkollës shqipe.

E veçantë tjetër e Kontratës së re është se MASHT dhe SBASHK do të kyçen në mënyrë aktive me qeveritë lokale në fazën e planifikimit të buxhetit të komunave në mënyrë që planifikimet të bëhen me kohë dhe të realizohen obligimet e komunave nga Kontrata Kolektive ( çështja e udhëtimit , pagave suplementare dhe e 3 pagave me rastin e pensionimit të punëtorëve të arsimit).

Po ashtu Kontrata precizon se MASHT dhe SBASHK , si partner të veçantë strategjik do të angazhohen bashkërisht në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Kontrata e re do të botohet së shpejti dhe do të jetë në duart tuaja anëtarë të nderuar të SBASHK-ut.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë,së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)** përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë,duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)


Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

*Intervistë me aktorin e sindikalistin z.Naser Zymberi*

### Naseri i dalluar në skenë dhe në angazhime sindikale



*Naseri rrëfen gjëra interesante në intervistën për gazetën tonë. Kishte krijuar me mjete modeste edhe një radio stacion. Skena për të është jeta vetë. Ka interpretuar 50 role në teatër e film. Është kryetar i shoqatës sindikale të Teatrit Profesional në Gjilan. Ai është i përkushtuar*

*që të zgjedh përmes SBASHK-ut kërkesat legjitime të kolegëve të tij. SBASHK-u të vazhdoj me këmbëngulësi për realizimin e qëllimeve të veta. Njerëzit kanë nevojë për frymëmarrje, për reflektim dhe kjo duhet t'u mundësohet", thotë Naseri.*

Arsimimi Sot:

**Kush është Naser Zymberi?**

Zymberi:

Jam lindur me 15.09.1958 në fshatin Budrikë e Epërme, komuna e Vitisë.

Qysh i vogël kam pasur pasion për dy fusha, atë të elektronikës dhe atë të aktrimit. Atëherë, kah moshën 14-15 vjeçare, si amator kisha punuar një radio transmetues të vogël dhe një antenë për të. Dhe ky radio transmetues mbulonte një pjesë të lagjes time e ndoshta edhe tërë fshatit tim. Atëbotë njihesha në shkollë dhe fshat edhe si recitues i mirë dhe i talentuar. Dashuria e madhe për profesionin e aktorit më bënte të lexoja tekste dramash, dhe sidomos përvoja t'i dramatizojta tregimet, po edhe romanet me vonë. Ato tekste të shkurtra, ato dialogje i incizojta në kasetofonin tim të vogël, njëherë vetëm, e pastaj angazhoja shokët dhe provoja t'i transmetoja si radiodrama nga transmetuesi im, për fshatin tim. Pastaj në vitin 1972, në klasën e shtatë të shkollës fillore luajta në shfaqjen "Vëllazëni dhe Interes" të Kristo Floqit nën përkujdesjen e arsimtarit të gjuhës shqipe Shaban Shabanit nga Tërpeza e Vitisë. Më vonë, shumë më vonë si student u angazhova në Teatrin Akademik "Ramiz Sadiku" që ishte teatër i studentëve. Ishte kjo shfaqja "Kaligula e Albert

Camy-se" në regji të Xhemil Vraniqit bashkë me studentët Basri Capriqi, Avdi Tmava, aktoren Melihate Qena e të tjerë. Atë kohë isha student në Fakultetin Filologjik në degën e Letërsisë dhe Gjuhës Shqipe. Më vonë më angazhuan në Teatrin e Qytetit të Gjilanit ku sot e asaj dite punoj si aktor. Kam luajtur afërsisht 50 role në teatër e film. Pas lufte kam qenë drejtor i teatrit. Tani jam zgjedhur kryetar i Shoqatës Sindikale të Teatrit. Jetoj dhe punoj në Gjilan.

Arsimimi Sot:

**Teatri juaj u bë pjesë e SBASHK-ut. Cilat janë kërkesat e veçanta të teatrit tuaj?**

Zymberi:

Tash, në dëshirojmë, si institucion kulturor i nivelit lokal ta heqim veten nga një institucion kulturor i diskriminuar kundrejt institucioneve të tjera lokale të kulturës. Ne nuk jemi në lista të pagave, pra nuk jemi të sistemuar si punëtorë të rregullt. Paradoksi qëndron në faktin se edhe ne jemi institucion kulturor i nivelit lokal, siç janë Biblioteka e Qytetit, Arkivi i Qytetit, Muzeu i Qytetit dhe institucione tjera të nivelit lokal, por që e kanë të rregulluar statusin financiar të punëtorit, si punëtor me pagë të rregullta. Pra, kërkesa jonë fillestare është që SBASHK-u të na përkrahë në zgjidhjen e këtij problemi. Jemi një teatër me një përvojë mbi 70 vjeçare. Historiku i teatrit tonë pasqyron rënie dhe ngritje edhe të statusit juridik. Në kohën e paraluftës stafi i teatrit, pra aktorët dhe stafi teknik kanë qenë të punësuar me pagë të rregullta. Viteve të 90-ta jemi përzënë nga teatri pas vendosjes së masave të dhunshme që pat vendosur regjimi i Millosheviqit edhe në institucionet e kulturës. Më pastaj, në vitin 2002, me një vendim të udhëheqjes komunale u futëm në pagë të rregullta, pastaj diku pas një viti na suspenduan nga pagat. Dhe prapë të pamposhtur kemi punuar dhe jemi ngritur me ligj në statusin e teatrit kombëtar, dhe ligjin për teatrin e pati nënshkruar Kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Nexhat Daci. Pastaj erdhën zgjedhje të reja, erdhi qeveri e re dhe na hoqi statusin e teatrit kombëtar duke propozuar

dhe miratuar ligj të ri për teatrin, për të na kthyer prapë në nivel lokal. Siç po shihet, ne kemi qenë vazhdimisht të sfiduar jo vetëm rreth statusit juridik të institucionit, po edhe statusit juridiko-financiar të aktorit dhe punëtorit të teatrit e që lidhej me statusin juridiko financiar të teatrit. Dhe përkundër gjithë këtyre trajtësimeve, ndryshjeve e besa edhe tjetërsimeve të ndryshme që kanë bërë ndaj neve, ne prapë kemi pasur rezultate shumë të mira e herë-herë edhe rezultate kulminante të fushës artistike, edhe të nivelit gjithëkombëtar. Pra kërkesë e vetme e jona kundrejt SBASHK-ut është ndihma e tyre për t'u rregulluar njëherë e përgjithmonë statusi financiar i rregullt i aktorit dhe punëtorit të teatrit.

Arsimimi Sot:

**Si e vlerësoni angazhimin e SBASHK-ut në realizimin e kërkesave të anëtarësisë?**

Zymeri:

Ne jemi shoqatë e re dhe po provojmë të vendosim baza të shëndosha dhe të qëndrueshme me Kryesinë e SBASHK-ut. Qëllimi ynë është funksionimi sa më normal i teatrit tonë. Mendoj se SBASHK-u ka bërë hapat e parë në realizimin e kërkesave tona, gjithnjë duke provuar t'i konkretizoj ato përmes formave të ndryshme të komunikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit të nevojshëm për t'i institucionalizuar, pra, për t'i ligjësuar ato. Kryesia e SBASHK-ut ka patur një takim para pak ditësh me Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ku është folur për finalizimin e punës rreth Kontratës Kolektive për Institucionet e Kulturës nga ana e SBASHK-ut, pjesë e së çiles do të jemi edhe teatrot, pra veç tjerash në atë takim është folur edhe për kërkesat tona, me emër e mbiemër për teatrin tonë, gjë të cilën unë e vlerësoj shumë. Kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut evoluojnë krahas zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe nevojave për absorbim nga ana e “konsumatorëve” tanë.

Arsimimi Sot:

**Çfarë duhet bërë që të jemi më të fortë edhe në sektorin e kulturës?**

Zymeri:

Mendoj që gjithëherë shoqatat sindikale dhe sidomos ato ballafaqohen me ndërhyrje të ndryshme nga brenda

dhe nga jashtë. Por para se shoqatat sindikale të përgatiten për sfida kundrejt problemeve dhe proceseve në vijimësi, ato duhet të themelohen, pra duhet të ekzistojnë. Në fushën e institucioneve të kulturës, sidomos atyre të nivelit lokal, kemi shumë pak, apo nuk ka fare organizim sindikal. Unë mendoj që në të gjitha institucionet lokale të kulturës duhet të themelohen shoqatat sindikale të SBASHK-ut, të regjistroheshin, dhe si të tilla, të bashkuara brenda një sindikate, thjesht, të jenë më të forta dhe më afër realizimit të kërkesave të tyre. Tash për tash jemi katër institucione të kulturës të regjistruara në SBASHK.

Arsimimi Sot:

**Çfarë prisni nga Kontrata Kolektive për Kulturë, që do të nënshkruhet nga MKRS dhe SBASHK?**

Zymeri:

Mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave sociale, shëndetësore dhe juridiko-financiare etj. të punëtorëve të institucioneve të kulturës.

Arsimimi Sot:

**Çka është e veçanta e profesionit të aktorit?**

Zymeri:

Detajet. Tërësia e përgatitjes profesionale të një roli përbrenda një shfaqjeje teatrore është e lidhur ngushtë me imtësitë performuese. E mira dhe e madhërishtja, si kategori estetike dallojnë mes tyre mu te detajet e realizimit të një veprë artistike. Ndërsa aktori duhet të jetë, veç i talentuar edhe shumë inteligjent për të kaluar nga një realizim i mirë artistik te një veprë e madhërishtme skenike. Një vrapues i shpejtësive nuk mund ta thyej rekordin në 100 metra, por është sportist i mirë, ndërsa tjetri vrapues i shpejtësive, arrin ta thyej rekordin në 100 metra në garën e njëjtë dhe ky është vrapues kulminant, kurse vrapimi i tij është i madhërishtëm. Kështu është edhe puna e realizimit të rolit, përkatësisht puna e realizimit apo e zhvillimit të aktorit. Njerëzit mund të mendojnë se puna e aktorit është ta mësoj tekstin përmendesh, por nuk mjafton vetëm kjo, sado e rëndësishme të jetë. Aktori veç tjerash duhet që brenda të qindtave të sekondës në skenë t'u jep përgjigje, miliona pyetjeve të momentit skenik.

Arsimimi Sot:

**Cila është porositja juaj konkrete për SBASHK-un?**

Zymeri:

Të mos dorëzohet përballë sfidave të ndryshme dhe sidomos ndërhyrjeve të ndryshme që mund t'i bëhen. Të ngul këmbë që çështjet e hapura të zgjidhen me dialog. T'i jap mundësi frymëmarrjes, pra të pres e të mos ngutet, sepse kështu i jep hapësirë mendimi palës së kundërt, por të mos ndalet, përkundrazi, të vazhdoj me këmbëngulësi për realizimin e qëllimeve të veta.

Njerëzit kanë nevojë për frymëmarrje, për reflektim dhe kjo duhet t'u mundësohet.

Arsimimi Sot:

**A keni diçka për të shtuar?**

Zymeri:

Uroj që revista të mos ndalet. Të vazhdoj punën. Ju faleminderit për komunikimin.

## Gjatë muajit

### MASHT dhe SBASHK nënshkruan kontratën e re Kolektive **Moment i veçantë për tërë arsimin e Kosovës**

Për të gjitha sindikatat kudo në botë moment i veçantë dhe arritje e madhe konsiderohet nënshkrimi i Kontratës Kolektive.



Lidhur me Kontratën e re Kolektive në arsimin e Kosovës kishin biseduar me kohë përfaqësuesit e SBASHK-ut me Ministrin Bajrami dhe Kabinetin e tij. Komisionet kishin punuar dhe pas takimeve negociuese kishin arritur të përgatitnin tekstin final të



Kontratës së re Kolektive për tërë arsimin e Kosovës. Ceremonia festive e nënshkrimit të

Kontratës së re u zhvillua në kabinetin e Ministrit Bajrami në prani të Zv/ministrit Mevludin Krasniqi, anëtarëve të Kabinetit dhe përfaqësuesve të SBASHK-ut.

Pas kësaj Ministri Bajrami dhe kryetari Jasharaj i janë drejtuar medieve të shkruara e elektronike.

"Kjo Kontratë parasheh obligimet e shtetit të Kosovës, obligimet e të gjitha komunave të Kosovës që të kujdesen që mësimdhënësit të kenë një pozitë adekuate materiale, që ata të stimulohen për të ngritur cilësinë, sepse rruga për ta ngritur cilësinë në arsim shkon përmes mësimdhënësve të përgatitur. Kontrata ofron një kornizë të gjerë të bashkëpunimit, jo vetëm në misionin klasik të Sindikatës që e ka çdo shtet, por edhe në një rol të ri përtej misionit, pra bëhet partner për stimulimin e mësimdhënësve, për ngritjen në karrierë, për zhvillim profesional dhe për vlerësim të performancës", është shprehur Ministri Bajrami, i cili ka lavdëruar SBASHK-un për korrektësinë dhe angazhimet, jo vetëm për realizimin e kërkesave të



anëtarësisë, por edhe në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.



Takimi i Këshillit Drejtues

## U debatua edhe për çështje të organizimit të brendshëm

Edhe pse Statuti i SBASHK-ut parasheh që takimet e Këshillit Drejtues duhet mbajtur më së shumti dy herë në vit, me qëllim që të dilet me vendime unike e të përkrahura nga të gjithë, takimet e Këshillit Drejtues janë shumë të shpeshta. Në takim të radhës së këtij organi të lartë të SBASHK-ut ishte analizuar situata aktuale dhe ish-in propozuar masa konkrete lidhur me Kontratën Kolektive dhe Ligjin për vitet 90-ta. Për këto dy çështje u debatua para medieve dhe anëtarësisë dhe opinioni kishin informacione të shumta. Në këtë shkrim do të ndalemi të dy çështjet tjera që janë debatuar po në këtë takim e që më pak u bënë të njohura për publikun.



Njëra nga çështjet që është analizuar në këtë takim ishte edhe rrjedha e zgjedhjeve nëpër shoqatat sindikale kudo në komunat e Kosovës. Pjesëmarrësve në këtë takim u është kujtuar edhe një herë vendimi se në mbledhjet zgjedhore nëpër shoqata duhet të jenë të pranishëm kryetari apo anëtar i i autorizuar i kryesisë së Kuvendit të SAF e SAM nga komuna gjegjëse. **“Takimet zgjedhore në shoqata sindikale në shkollat e komunës suaj duhet të monitorohen nga kryetari ose nga anëtar i autorizuar i Kryesisë së Kuvendit tuaj dhe se duhet të respektohet vendimi**

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj e ka cilësuar si ngjarje të veçantë nënshkrimin e Kontratës. “Kontrata e re Kolektive e sa po nënshkruar përcakton të drejtat dhe obligimet, jo vetëm në Arsimin Parauniversitar, por edhe në Universitetet e Kosovës. Kontrata e re Kolektive e arsimit në Kosovë përcakton të drejta të posaçme dhe obligimet e të punësuarve në institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar dhe atij universitar”, ka thënë në ceremoninë festive kryetari i SBASHK-ut.

**i 1 shkurtit 2017, i cili ka këtë përmbajtje”, u rikujtua në këtë takim e pastaj u shpërnda edhe vendimi lidhur me zgjidhjet, i cili ka këtë përmbajtje:**

1. **Takimet zgjedhore** të shoqatave që nuk janë monitoruar nga kryetari apo anëtar i autorizuar i nivelit komunal konsiderohen të pavlefshme,
2. Kjo vlen edhe kur do të mbahen Kuvendet zgjedhore në nivel komunal. Nëse ato Kuvende zgjedhore mbahen pa praninë e kryetarit apo personit të autorizuar nga Kryesia qendrore, zgjidhjet atje konsiderohen të pavlefshme.
3. Personi që zgjidhet në cilin do funksion duhet të jetë pa tjetër anëtar i SBASHK-ut.
4. Për të qenë kryetar legjitim i një shoqate sindikale individ duhet të jetë në listën e pagave të asaj shkolle. Pra, nuk mund të zgjidhet në postin e kryetarit të shoqatës së një shkolle individ që është në listën e pagave në një shkollë tjetër.



Po ashtu në këtë takim është debatuar edhe për traditën e mirë të SBASHK-ut që të dërgohen pushues në bregdetin shqiptar. Menaxheri për financa e

administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri ka njoftuar anëtarët e Këshillit Drejtues lidhur me nismën e përgatitjeve për këtë aktivitet. “Duke vazhduar me këtë traditë të SBASHK-ut për dërgimin e anëtarëve nga secila

komunë dhe nga njësitë akademike të Universiteteve për pushime në bregdetin shqiptar. Ai ka informuar se bazuar në buxhetin për pushim e rekreacion do të shkojnë për pushim 1 në 52 anëtarë të SBASHK-ut”, ka shpjeguar z. Ymeri.

Takim përmbajtjesor me Ministrin e Kulturës, Kujtim Shala

## Pajtueshmëri për Kontratën Kolektive në sektorin e kulturës

Pas nënshkrimit të Kontratës së re Kolektive për gjithë arsimin e Kosovës, SBASHK-u po vazhdon me angazhimet që edhe sektori i kulturës të ketë Kontratë Kolektive. Për këtë kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj bashkë me menaxherin për financa e administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kishin biseduar me Ministrin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Shala, nga i cili kishin marrë mbështetjen me kohë. Edhe në takimin e radhës mes të dy palëve ministri Shala ka inkurajuar SBASHK-un që të shtohen angazhimet e përfaqësuesve të sektorit të kulturës për ta përfunduar sa më parë tekst propozimin e Kontratës Kolektive për këtë sektor në mënyrë që pas negociimit me komisionin e kësaj Ministrie të përgatitet një tekst i pranueshëm për të dy palët dhe të bëhet edhe ceremonia e nënshkrimit të saj.



Në këtë takim përveç për nevojën e nënshkrimit të Kontratës, Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj ka njoftuar Ministrin Shala për çështjet e ngritura nga aktorët rezidentë të Teatrit Kombëtar të Kosovës, nga ata të Teatrit të Gjilanit dhe nga anëtarësia në institucione të tjera kulturore.

Ministri Kujtim Shala i ka thënë delegacionit të SBASHK-ut se është i informuar për çështjet e ngritura dhe se po bën angazhime të shumta për realizuar brenda mundësive buxhetore dhe Ligjeve e akteve të tjera këto kërkesa. “Unë nuk jam për zgjidhje parciale, porse po punohet Rregullorja që ofron zgjidhje të çështjeve për të gjitha institucionet e kulturës, pra edhe për Teatrin Kombëtar”, ka deklaruar Ministri Shala. Ministri i Kulturës ka shtuar se lidhur me kërkesat e Teatrit të Gjilanit, ato janë legjitime dhe se duhet të gjejnë zgjidhje në nivel komunal.

Delegacioni i SBASHK-ut edhe në këtë takim ka rikujtuar çështjen e Ligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta dhe ka lutur Ministrin Shala që të vazhdojë me angazhimet që ky Projektligj të arrij sa më parë në Qeveri e pastaj të procedohet në parlament.

Takim me kryeministrin Mustafa dhe kabinetin e tij

## Kryetari i SBASHK-ut i kërkoi Kryeministrin të vazhdojë me mbështetjen për Ligjin e viteve 90-ta

Një delegacion i BSPK-së, i kryesuar nga kryetari Haxhi Arifi, është pritur nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, Isa Mustafa dhe Ministrat Avdullah Hoti e Arban Abrashi. Në kuadër të delegacionit të BSPK-së ishte edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman

Jasharaj. Në një bashkëbisedë të gjatë Kryeministri Mustafa dhe Kabineti i tij kanë dëgjuar me kujdes përfaqësuesit e punëtorëve, të cilët po shpalosnin aktualitetin dhe hallet në sektorët që përfaqësonin.



Kryetari i SBASHK-ut , Jasharaj ka informuar Kryeministrin lidhur me rrjedhën e angazhimeve të Ministrisë së Punës, të asaj për Financa, MASHT-it dhe SBASHK-ut lidhur me finalizimin e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta. Ai pastaj i është drejtuar Kryeministrit Mustafa me apelin në

emër të të gjithë anëtarësisë që ai të vazhdojë me angazhimet lidhur me këtë ligj në mënyrë që ai të vij në Qeveri dhe pastaj të procedohet në Parlament.

Kryeministri Mustafa ka shprehur edhe një herë gatishmërinë për angazhim lidhur me këtë çështje dhe ka shtuar se Projektligji do të jetë shumë shpejtë në Qeveri dhe do të procedohet tutje për në Parlament.

Në kudër të bashkëbisedës kryetari i SBASHK-ut , Rahman Jasharaj ka kërkuar në emër të anëtarësisë dhe të punësuarve të tjerë në Kosovë që Qeveria të nis përgatitjet për ngritje pagash , së paku , ashtu si ka deklaruar Qeveria, në bazë të ngritjes ekonomike në Kosovë.

Sindikalistët në këtë takim kanë shtruar edhe çështjen e Ligjit mbi skemat pensionale dhe kanë kërkuar që kriteri prej 15 të zbritet në 10 vite kontributdhënëse për të fituar të drejtën për pension të plotë të punës.

Realizohet me sukses agjenda e takimeve të SBASHK-ut nëpër komunat e Kosovës

## Mbështetje e fuqishme për SBASHK-un kudo në Kosovë

Edhe në muajin prill SBASHK-u ka vazhduar se realizuari agjendën e takimeve me anëtarësinë nëpër komunat e Kosovës. Në kuadër të këtij angazhimi janë mbajtur takimet e Kuvendeve të SAF e SAM për Komunitet e Prizrenit, Rahovecit, Mitrovicës, Kastriotit ( Obiliqit), Shtimes dhe Vushtrrisë.



Në takimin e Kuvendit të SAF e SAM për Komunitetin e Prizrenit, kryetari i këtij Kuvendi , Reshit Kushaj ka përshëndetur fillimisht kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe menaxherin për financa, administratë e këshilltar për organizim të brendshëm,

Ymer Ymeri e pastaj ka shpalosur aktivitetet e zhvilluara sindikale në këtë komunë. Pjesëmarrësit në këtë takim kanë lavdëruar arritjet e SBASHK-ut dhe në bashkëbisedë kanë shtruar edhe shumë pyetje , të cilave u janë përgjigjur Jasharaj e Ymeri.

Një takim i suksesshëm e përmbajtësor ishte edhe ai i Kuvendit të SAF e SAM për komunën e Mitrovicës. Kryetarja e këtij Kuvendi, Vjollca Shala ka kujtuar për angazhimet dhe arritjet sindikale në këtë komunë, kurse kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj dhe menaxheri për financa, administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë treguar për Kontratën e re Kolektive të nënshkruar nga SBASHK dhe MASHT dhe për Ligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të viteve të 90-ta . Ata u janë përgjigjur edhe shumë pyetjeve të pjesëmarrësve, të cilët kanë përgëzuar SBASHK-un për angazhimet e arritjet dhe janë zotuar se do të vazhdojnë me unitetin e fuqishëm sindikal.





Takim i organizuar mirë ishte edhe ai i Kuvendit të SAF e SAM për komunë e Rahovecit. Kryetari i këtij Kuvendi Veli Morina ka treguar për aktivitetet sindikale të zhvilluara në këtë komunë, kurse kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa, administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri u janë përgjigjur pyetjeve konkrete të anëtarëve të këtij Kuvendi.



Bashkëbisedë përmbajtjesore është zhvilluar edhe në takimin e Kuvendit të SAF e SAM për komunën e Vushtrrisë. Kryetari i këtij kuvendi , Alush Maloku ka folur për arritjet dhe sfidat në arsimin e Vushtrrisë e pastaj kryetari Jasharaj bashkë me menaxherin për financa, administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri bashkë me nënkryetarin Lutfi Mani kanë dhënë shpjegime lidhur me Kontratën e re Kolektive dhe Ligjin për statusin e mësimdhënësve të viteve të 90-ta. Ata, po ashtu, u janë përgjigjur shumë pyetjeve të pjesëmarrësve në këtë takim.



Atmosferë korrekte e bashkëbisedës ishte edhe në takimin e Kuvendit të SAF e SAM të komunës së Shtimes. Në hyrje të takimit kryetari Xhavit Rexhaj ka përshëndetur nënkryetarin e SBASHK-ut, Rexhep Sadiku e pastaj ka bërë një vështrim të angazhimeve dhe arritjeve sindikale në këtë komunë. Nënkryetari i SBASHK-ut, Rexhep Sadiku u është përgjigjur shumë pyetjeve të pjesëmarrësve e që kishin të bënin më shumë me Kontratën e re Kolektive dhe me ligjin për statusin e mësimdhënësve të viteve të 90-ta.

Kryetari Jasharaj bashkë me menaxherin për financa, administratë e këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri kanë marrë pjesë edhe në Kuvendin e SAF e SAM të komunës së Kastriotit ( Obiliqit). Në këtë takim kryetarja Luljeta Boshnjaku ka folur fillimisht për arritjet dhe sfidat sindikale në këtë komunë e pastaj bashkë me përfaqësuesit e SBASHK-ut u janë përgjigjur shumë



Se SBASHK-u po forcohet vazhdimisht tregon fakti se përfaqësuesit e tij janë kthyer në qendër me lista , në të cilat janë shënuar një numër i madh i anëtarëve të rinj.

Pas një angazhimi të përkushtuar të Këshillit Shtetëror të Licencimit

## U promovuan dokumente me rëndësi për zhvillimin profesional të mësimeve

Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimeve, në të cilin përfaqësohet edhe SBASHK-u, ka bërë një angazhim të përkushtuar në përgatitje të dokumenteve me rëndësi e që kanë të bëjnë me licencimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimeve. Me të përfunduar të këtij angazhimi, Ministri Bajrami ka analizuar dhe ka

aprovuar Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimeve në Kosovë dhe katër Udhëzime Administrative që janë në mbështetje të kësaj strategjie. Pas kësaj MASHT-i në një solemnitet rasti ka bërë promovimin e këtyre dokumenteve. Duke përshëndetur pjesëmarrësit e kësaj ceremonie Ministri Bajrami ka treguar për rëndësinë e këtyre dokumenteve dhe është shprehur se ato do të jenë ndihmesë në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsim.

Në këtë ceremoni janë promovuar këto dokumente:

“Korniza strategjike për zhvillimin e mësimeve në Kosovë”,  
Udhëzimi Administrativ për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillimin profesional të mësimeve dhe punonjëseve arsimorë”,  
“Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar”,  
“Udhëzimi Administrativ për Këshillin Shtetëror të Licencimit të Mësimeve” dhe  
“Udhëzimi Administrativ për sistemin e licencimit dhe zhvillimit të mësimeve në karrierë”.

